



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d), 17 shkronja f) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 8 paragrafi 1.3 dhe 10.2 të Ligjit për Mbeturinat 04/L-060, Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013 – 2022, dhe neneve 15.2 shkronja d) dhe 19 shkronja f) të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10, Kuvendi i Komunës i Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 02 shkurt 2017, miratoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS PËR PERIUdhËN 2017 - 2022

Neni 1

Miratohet Plan i Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës për periudhën 2017 - 2022

Plani është i harmonizuar me Planin e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave 2013 - 2017

Neni 2

Plani është i hartuar nga Komuna e Podujevës, në bashkëpunim me GIZ dhe Kompaninë Eco Design & Engineering Solution.

Neni 3

Pjesë përbërëse, sipas nenit 1 të këtij Vendimi është Plan i Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës për periudhën 2017 - 2022.

Neni 4

Zbatimin e Planit e bëjnë Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Inspeksionit dhe Institucionet tjera kompetente lokale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-060/01-5974/17
Podujevë,
02 shkurt 2017



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi